



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇE



Nr. 86 Akti

Korçë, me 20.05.2020

**SHPLLJE VENDIMI**

Në këndin e afishimit të shpalljes pranë Njesise Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

Për shtetasit: **Enkelejda Ago dhe Ardian Ago**

Me adresë: Fshati Drithas, Bashkia Maliq.

Bashkalidhur po ju dërgojme shpalljen për vendimin nr. **86, dt. 21.01.2020** për t'u afishuar nga ana e juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor*, pasi deftesa e komunikimit është kthyer me shënimin larguar ne Greqi dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.



U afishuar sot ne dt \_\_\_\_\_

Nëpunësi \_\_\_\_\_

(emër, mbiemër, firmë)

- Uj: Ad. Libonik  
- Drij. Tek. Mbrodh. Publikum ✓  
11.06.2020



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KORÇË**

Nr. Regj. Them. 21001-02208-41-2019 (539/1875)  
Data e Regjistrimit 20.12.2019

Nr. Vendimit 41-2020-248(86)  
Data e Vendimit 21.01.2020

**VENDIM**

**“Ne emer te Republikes”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, e përbërë nga:  
gjyqtare e vetme - **Ariola Kristo,**

asistuar nga sekretare séance Onada Hajdini, në Korçë, sot më datë 21.01.2020, ora 13.33, mori në shqyrtim në seancë pajtimore me dyer të hapura, çështjen civile me nr.regj.them. 21001-02208-41-2019 (539/1875), që i përket:

**Paditese:** Enkelejda Ago, e bija e Spiros dhe e Mirjetes, e datelindjes 28.06.1976, lindur ne Maliq e banuese ne Drithas, Korçë, aktualisht me vendqendrim ne Greqi qe prej shume vitesh.

**I paditur:** Ardian Ago, i biri i Ibrahimit dhe i Lirijes, i datelindjes 08.08.1969, lindur e banues ne Drithas, Korçë, aktualisht me vendqendrim ne Greqi qe prej shume vitesh.

**Objekti:** Zgjidhje e martesës ligjore e dates 15.03.1993.

**Baza ligjore:** Neni 132 i Kodit te Familjes.

Gjykata, gjate zhvillimit te seances pajtimore, ne prani te paditeses e te te paditurit

**VËREN**

Paditesja Enkelejda Ago, nepermjet kerkesepadise se paraqitur ne gjykate, ka kerkuar zgjidhjen e martesës ligjore te lidhur midis saj e te paditurit Ardian Ago, martese e lidhur ne daten 15.03.1993.

Fillimisht, gjykata ne mbeshtetje te nenit 134 te Kodit te Familjes, caktoi seancen e perpjekjeve per pajtim, e cila eshte e detyrueshme per t’u zhvilluar ne gjykimet me objekt zgjidhje martese. Ne seancen pajtimore te dates 21.01.2020, ora 13.30, ne te cilen ishin prezent te dy palet ndergjyqese, pas marrjes se deklarimeve e pretendimeve te tyre e pas berjes se perpjekjeve per pajtim, paditesja Enkelejda Ago, kerkoi heqjen dore nga gjykimi, duke pranuar pushimin e tij, pasi do te pajtohej me te paditurin. Ne lidhje me kete kerkesë te saj, ishte dakort dhe i padituri (seanca audio dt.21.01.2020 e sinteza e procesverbalit te kesaj date fq.2).

Nr. 76 Prot  
Dt. 12.06.2020